

## GRUPACIONI TRIGLAV

[Grupacioni Triglav](#) është një grupacion sigurimesh dhe financiar lider në Slloveni dhe rajonin e Adriatikut dhe një nga më të mëdhatë në Evropën Juglindore.

Zavarovallnica Triglav, kompania mëmë e Grupacionit Triglav, së bashku me filialet dhe kompanitë e saj është e pranishme në shtatë tregje, në gjashtë vende dhe punëson pothuajse 5.000 njerëz.

Me njohuritë, përvojën dhe fuqinë e tij financiare, Triglav për më shumë se 120 vjet justifikon besimin e klientëve se ai do të kujdeset më së miri për sigurinë dhe të ardhmen e tyre. Shtyllat kryesore të punës janë sigurimi dhe menaxhimi i pronës.

Grupacioni Triglav ruan stabilitet të fortë financiar, mjaftueshmëri të lartë të kapitalit dhe përfitim në punë, gjë që konfirmohet nga vlerësimi i lartë i kredisë »A«, dhënë nga dy agjenci të njohura të vlerësimit të kredisë. Me vizionin, vlerat dhe drejtimit e tij strategjike, ai ndjek zhvillimin e tij drejt një grupacioni modern, dixhital dhe dinamik të sigurimeve-financiare, i cili qëndron fort në pozicionin lider në Slloveni dhe më gjerë, në rajon. Vlerat kryesore të kompanisë janë thjeshtësia, shkathtësia dhe konfidencialiteti, dhe me misionin e tij përpiqet të ndërtojë një të ardhme më të sigurt. Me vizionin e tij, ai përpiqet për zhvillim dinamik të mënyrave të reja të punës, të cilat bazohen në zhvillimin e përgjegjshëm, afatgjatë, dhe në të njëjtën kohë punon me fitim dhe siguri.

## DREJTIME STRATEGJIKE

- ✓ Stabilitet dhe përfitim afatgjatë në procesin e punës dhe vlerë më e madhe e Grupacionit Triglav;
- ✓ Fokus ndaj klientit dhe zhvillim i shërbimeve përkatëse;
- ✓ Zhvillim i një organizate dhe kulture bashkëpunuese dhe të shkathët.

## PËR KOMPANINË

Kur ke një vizion për të ardhmen, duhet t'i japësh jetë dhe të lejosh të jetosh pa kufizime. Jeta është plot mundësi. Ndonjëherë di të jetë naive si fëmijë, por me shumë emocione. Është plot me sfida, por ne do të arrijmë majën vetëm nëse fillojmë të ngjitemi.

Prandaj, jetoje jetën siç dëshiron, të mbështjellë me dashuri dhe siguri.

Çdo ditë ne krijojmë një të ardhme më të sigurt për siguruesit, pronarët, partnerët tanë të biznesit dhe, natyrisht, punonjësit tanë. Prandaj, secili prej nesh si individ dhe të gjithë së bashku si një ekip, besojmë se me punën tonë të përditshme dhe profesionale, kontribuojmë në sigurinë. Në çdo hap, sado i vogël, mund të shtrijmë një dorë dhe të ofrojmë siguri. Kjo vlen si në kohën e paqes, ashtu dhe në kohën e pasigurisë dhe ndryshimeve.

E ardhmja e Grupacionit Triglav është plot shpresë dhe besim, shumë punë dhe përkushtim, por edhe një vizion, në të cilin fokusi është klienti, si dhe zhvillimi i mënyrave të reja të punës, të bazuara në zhvillimin tonë të përgjegjshëm dhe afatgjatë.

Burimi për rritjen e përfitimit janë shërbimet mjaft konkurruese dhe cilësore, kontrolli efikas i rreziqeve dhe stabiliteti financiar i Grupacionit Triglav.

Në çdo organizatë të suksesshme afatgjate, marka është ajo që garanton cilësinë dhe njohjen, e cila është veçanërisht e rëndësishme për organizatat që ofrojnë shërbime.

Besimet tona më të thella ne i përmbledhim në vlerat thelbësore të markës, të cilat i realizojmë çdo ditë në marrëdhëniet tona të ndërsjella dhe në marrëdhëniet me mjedisin:

## **Shkathësi**

Ne përpiqemi t'u përgjigjemi sfidave shpejt dhe me efikasitet.

## **Thjeshtësi**

Fokusi ynë janë klientët, kështu që produktet dhe proceset tona janë të thjeshta, me cilësi të lartë dhe transparente.

## **Konfidencialitet**

Ne i përmbushim premtimet e dhëna dhe krijojmë besim tek klientët tanë

Pavarësisht vlerave tona, ne mbetemi përgjegjës shoqëror.

Zhvillimi i qëndrueshëm i Grupacionit Triglav bazohet në përgjegjësinë shoqërore, e cila përfshin aspekte ekonomike, ligjore, etike dhe filantropike..

Bërthama e çdo marke të fuqishme është identiteti i saj. Është themeli i punës dhe i të gjitha ndryshimeve në të ardhmen, të cilat do të çojnë në zhvillim të qëndrueshëm me një reputacion të shkëlqyeshëm. Identiteti i markës Triglav konsiston në integritetin në veprim, aksesin në komunikim, familjen si burim frymëzimi dhe motivimi dhe në ofertën me vlerën më të madhe.

Në Shoqërinë Pensionale Triglav, ne jemi të përkushtuar në përmirësimin e vazhdueshëm të organizimit, proceseve dhe procedurave, cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, të marrëdhënieve brenda kompanisë, si dhe me klientët dhe partnerët e biznesit. Ne besojmë se perceptimi i kompanisë, si dhe zhvillimi i saj i qëndrueshëm janë kryesisht në duart e vetë punonjësve dhe varen nga vlerat, ekspertiza dhe gatishmëria e tyre për të mësuar.

## **RAPORTE**

Përmbajtja e faqes është e disponueshme vetëm në maqedonisht

## **KARTA E IDENTITETIT**

Shoqëria për administrim me fondet pensionale të obliguara dhe vullnetare, Shoqëria Pensionale Triglav SHA Shkup, ose shkurtimisht Shoqëria Pensionale Triglav SHA Shkup është një shoqëri aksionare, e regjistruar dhe me seli në Republikën e Maqedonisë, e cila kryen veprimtari tregtare në fushën e sigurimit pensional.

Kompania është anëtare e Grupacionit Triglav, një nga grupacionet më të mëdha të sigurimeve dhe financiare në rajonin e Evropës Juglindore. Aktiviteti i punës së Shoqërisë Pensionale Triglav është administrimi i fondeve pensionale të hapura të obliguara dhe vullnetare. Kompania në tregtinë e jashtme, në emër dhe për llogari të fondeve pensionale që administrojnë, në kushte të përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret përkatëse, bën tregti me instrumente financiare.

Selija: Bul.8 Shtatori nr.18, kati 2, 1000 Shkup

Numër tatimor: 4057019545071

Numër identifikimi

i personit tregtar: NIPT: 7344228

Kod identifikimi:

Kapitali themelor: 3.000.000,00 EUR

Numri i aksioneve: 60.000

Kryetar i Bordit drejtues: Vojdan Jordanov

Anëtar i Bordit drejtues: Marijan Nikolovski

Kontakt: 02 5102 190

Faqja e internetit: <http://www.triglavpenzisko.mk> / <http://www.triglav.eu>

E-adresa: [info@triglavpenzisko.mk](mailto:info@triglavpenzisko.mk)

Data e regjistrimit në regjistrin tregtar, në kuadër të Regjistrimit Qendror në RM 2019

Aktiviteti i Shoqërisë Pensionale Triglav, në përputhje me Klasifikimin nacionale të aktiviteteve  
66.30 aktivitete të menaxhimit me fonde

Aktiviteti i Grupacionit Triglav: Sigurim dhe ri-sigurimi, Menaxhim me fonde investuese dhe pronë financiare

Shoqëria Pensionale Triglav ka leje për ushtrimin e aktivitetit nga ana e Agjencisë për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensionsal (MAPAS). Për qasje në faqen e internetit të MAPAS, [shtypni këtu](#).

Për qasje në Statusin e Shoqërisë Pensionale Triglav [shtypni këtu](#).

Për qasje në Statusin e Fondit pensional të hapur të obliguar Triglav Shkup, [shtypni këtu](#).

Për qasje në Statusin e Fondit pensional të hapur vullnetar Triglav Shkup, [shtypni këtu](#).

Për qasje në prospektin informues të fondit pensional të hapur, të obliguar Triglav-Shkup, [shtypni këtu](#).

Për qasje në prospektin informues të fondit pensional të hapur, vullnetar Triglav-Shkup, [shtypni këtu](#).

Shoqëria Pensionale Triglav, në veprimtarinë e saj drejtohet sipas [Kodit të Grupacionit Triglav](#), i cili përcakton vlerat themelore dhe parimet e funksionimit, arritjen ligjore dhe etike të qëllimeve të biznesit, drejtimet strategjike dhe përparësitë mbi konkurrencën, duke respektuar parimet dhe standardet për punë të ndershme dhe transparente.